

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 620 Prot.

Tiranë, më 10.062016

VENDIM Nr. 63, datë 08.06.2016

Në mbështetje të **Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7 të datës 08.06.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të **projektit "Kapanone industriale", Kashar - subjekti "ALBACO SHOES", sh.p.k.**, realizuar nga shoqëri i licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të **projektit "Kapanone industriale", Kashar - subjekti "ALBACO SHOES", sh.p.k.**, realizuar nga shoqëri i licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja arkeologjike nga DRKK Durrës, e cila duhet të depozitohet pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dokumentacionin për të, duke lidhur më parë akt-marrëveshje tre palëshe me ASHA dhe investitorin sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

